



Vjetar informativ i Departamentit të Antropologjisë
Fakulteti Filozofik, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"
Tetor 2019 / Nr. 1



SEMINARI I ANTROPOLOGJISË 2019-2020

*"Antropologjia është konverzacion i shtruar
mbi lirinë dhe kulturën njerëzore"*

**Departamenti i Antropologjisë ofron
studime të nivelit BA në antropologji
(180 ECTS kredite, 3 vjet)**

Studimet profilizohen në dy degë:

- a) antropologji kulturore**
- b) arkeologji**

**Viti i parë akademik është i përbashkët,
ndërsa në vitin e dytë studentët ndjekin
profilin e zgjedhur. Departamenti shquhet për mundësinë
që u jep studentëve në punë praktike dhe projekte hulum-
tuese.**

**Për më shumë, lexoni doracakun për
studentë, në uebfaqen e Departamentit
të Antropologjisë**

<http://filozofiku.uni-pr.edu/Departamentet/Departamenti09.aspx>

**ose na shkruani në
antropologjia@uni-pr.edu.**

Mirë se vini!

LETRA E REDAKSISË

Të nderuar lexues,

Ky është numri i parë i vjetarit informativ të Departamentit të Antropologjisë, të cilën e kemi titulluar “AA”, një shenjë e bashkëpunimit të frytshëm të dy degëve të antropologjisë: antropologjisë kulturore dhe arkeologjisë.

Në këtë vjetar do të gjeni informata rreth ngjarjeve të ndryshme që kanë ndodhur gjatë vitit akademik në kuadër të punës së Departamentit të Antropologjisë. Në këtë numër, por edhe në numërat e ardhshëm, do të gjeni shkrime të cilat, në përgjithësi, tregojnë dinamikën e punës në departamentin tonë.

Duke njohur historinë e Departamentit, i cili ka kaluar nëpër pragje të ndryshme deri sa ka arritur në këtë pozitë, duhet thënë se gjërat kanë evoluuar duke u përmirësuar. Në vitin 2014, Departamenti nisi edhe me degën e arkeologjisë dhe në vitin 2017 u riakreditua për 5 vite. Kështu, me gjithë sfidat e rekrutimit të stafit dhe drojën e pamundësisë së riakreditimit, Departamenti vazhdoi me programin e vet BA, të përbërë nga dy degë.

Prej vitit 2014 e deri më tani, kolegët e Departamentit kanë nisur një sërë projektesh si në antropologji kulturore ashtu edhe në arkeologji, si me institucione vendore ashtu edhe me institucione ndërkombëtare, duke ofruar mundësi të reja hulumtimi në Departament.

Në vitet e fundit, Departamenti ka rekrutuar disa profesorë dhe asistentë, të rregulltë dhe të an-

gazhuar, duke krijuar larmi të specializimit në studimet antropologjike dhe pluralizëm të mendimit akademik. Po ashtu, një numër i studentëve tanë kanë vazhduar studimet në universitete evropiane, disa me bursa të plota. Nga ana tjetër, marrëveshjet e bashkëpunimit të Departamentit të Antropologjisë me institucione të ndryshme, kanë hapur mundësi të shumta për punë praktike për studentët tanë. Kemi pasur edhe ligjërues vizitorë përmes programit ERASMUS, por edhe profesorë të Departamentit kanë ligjëruar në universitete të ndryshme evropiane. Po ashtu, në tetor të vitit 2018, Departamenti ka nisur edhe Seminarin e Antropologjisë, përmes së cilit janë mbajtur 9 ligjërata mysafire.

Si do të lexoni në faqet e këtij vjetari, stafi dhe studentët e Departamentit të Antropologjisë kanë krijuar një ambient të mirë të mësimdhënies e mësimnxënies, duke gërshtuar studimet me punën e tyre praktike. Përmes ligjëratave mysafire, pjesëmarrjes së stafit në konferenca e seminare të ndryshme, botimit të vazhdueshëm, gërmimeve arkeologjike, realizimit të projekteve të ndryshme, Departamenti i Antropologjisë ka arritur të ngjallë konverzacionin antropologjik e arkeologjik në Kosovë.

Në bazë të strategjisë së Fakultetit Filozofik dhe UP-së, Departamenti i Antropologjisë do të bëjë hulumtimet dhe përgatitjet e nevojshme që të aplikojë për akreditim të programit MA në Antropologji Kulturore, në vitin e

ardhshëm. Gjatë këtij viti akademik do të shqyrtojmë edhe mundësinë e progameve MA profesionale për fushën e trashëgimisë kulturore. Po ashtu, një ndër lajmet e fundit është suksesi në aplikacionin për projektin 4 vjeçar të hulumtimit në Ulpianë, mes Departamentit të Antropologjisë, Institutit Arkeologjik të Kosovës dhe Ecole Normale Supérieure nga Franca, që do të nisë sivjet.

Andaj, duke parë dinamikën dhe vëllimin e punës së stafit dhe studentëve të Departamentit, kemi vendosur që të nisim një vjetar, si platformë për t'i ndarë informacionet për punën tonë me kolegët, studentët, dashamirët e antropologjisë dhe lexuesin e gjerë. Vjetari do të jetë i përvjetshëm dhe do të botohen edhe në format të shtypur edhe në atë digjital.

Pyetja e parë që lexuesi mund të bëjë është “çka është antropologjia?”. Shkurt e gjerë: antropologjia është konverzacion i ngjeshur mbi lirinë dhe kulturën njerëzore. Por, duhet një jetë e tërë për ta mishëruar kuptimin e këtij definimi filozofik në mendim e praktikë hulumtuese.

Shpresojmë se në faqet në vijim do të gjeni informacione për punën e veçantë që bëhet në Departamentin e Antropologjisë, në vazhdë të këtij konverzacioni.

Arsim Canolli

Udhëheqës i Departamentit të Antropologjisë

AA, Nr. 1, Tetor, 2019

Vjetar informativ i Departamentit të Antropologjisë, Fakulteti Filozofik, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”

Redaksia: Arsim Canolli (kryeredaktor, emaili: arsim.canolli@uni-pr.edu); Arben Hajdari (redaktor - arben.hajdari@uni-pr.edu); Durim Abdullahu (redaktor - durim.abdullahu@uni-pr.edu). Del njëherë në vit, në formë të shtypur dhe digjitale.

Uebfaqja: <http://filozofiku.uni-pr.edu/Departamentet/Departamenti09.aspx>

Ballina © Besjana Rrahmani, “Vajzat e SHKA “Malësori” nga fshati Gjonaj i Hasit”

INFO & AKTIVITETE


Gjatë vitit akademik 2018-2019, stafi dhe studentët e Departamentit të Antropologjisë kanë realizuar një numër të madh aktivitete, si në projekte hulumtuese ashtu edhe në konferenca shkencore, simpoziume dhe botime.

Doracaku për studentë

Departamenti i Antropologjisë ka botuar një doracak për studentë, të parin e këtij lloji të ofruar në Universitetin e Prishtinës, si një letërnjoftim për studentët ekzistues dhe studentët potencialë të antropologjisë, por edhe për të interesuarit e tjerë që duan të dinë më shumë për studimet antropologjike në Universitetin e Prishtinës. Doracaku është përpiluar nga stafi i Departamentit të Antropologjisë dhe përmbledh informacion rreth strukturës së programit studimor, projekteve hulumtuese, këshilla dhe udhëzime të ndryshme për hulumtimin dhe shkrimin antropologjik. Vegza për ta zbardhur doracakun në formë dixhitale (PDF) është në uebfaqen e Departamentit të Antropologjisë, në kuadër të Fakultetit Filozofik: <http://filozofiku.uni-pr.edu/Departamentet/Departamenti09.aspx>

DEPARTAMENTI I ANTROPOLOGJISË

Doracak për studentë
2019-2020



Projekti dhe ekspozita “Kujtesa e Kosovës”



Mbi 2000 vizitorë kanë vizituar ekspozitën “Kujtesa e Kosovës”

Më 28 qershor 2019, në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës “Pjetër Bogdani” u promovua projekti “Kujtesa e Kosovës” 100 rrëfime nga 100 pleq e plaka”, i realizuar nga Biblioteka Kombëtare e Kosovës dhe Departamenti i Antropologjisë. Ky projekt që përmban 100 intervista autobiografike të pleqve mbi 80 vjeç u realizua nga 2 profesorët e Departamentit të Antropologjisë, Arsim Canolli dhe Ukë Xhemaj, dhe 15 studentët të antropologjisë kulturore të këtij departamenti. Projekti zgjati 2 vite. Në qershor u botuan transkriptet e 100 intervistave autobiografike në 10 vëllime dhe DVD me të gjitha audioincizimet e intervistave. Intervistat janë rrëfime autentike të të moshuarve për jetën e tyre prej fëmijërisë deri në pleqëri, duke përfshirë tema të ndryshme të ngjarjeve politike, ekonomike, kulturore, sociale e religjioze. Përmbledhja e këtyre intervistave do të jetë një referencë shtesë për historinë gojore të Kosovës, si për antropologët e sociologët ashtu edhe për gjuhëtarët, folkloristët, historianët, e të tjerët.

Më 28 qershor u mbajt edhe ekspozita me fotografi, me citate nga intervistat dhe audio-instalacione të intervistave, e cila qëndroi hapur për 2 javë në hollin e Bibliotekës Kombëtare.

Gjatë këtij projekti 15 studentët hulumtues kanë marrë përfituar nga pjesëmarrja në 12 trajnime e punëtori të ndryshme të organizuara nga mentorët e projektit dhe trajnerët nga SHBA, Alexandra Kelly (New York Library) dhe Suzanne Snider (Oral History Independent).

Studentët e antropologjisë kulturore shënojnë Ditën Ndërkombëtare të Muzeve

Këshilli Ndërkombëtar i Muzeve (ICOM) me 18 Maj shënon Ditën Ndërkombëtare të Muzeve me qëllim që të angazhojë publikun dhe të nxjerr në pah rëndësinë e rolit të muzeve si institucione që i shërbejnë shoqërisë dhe zhvillimit të saj. Studentët e Departmentit të Antropologjisë në bashkëpunim me Muzeun Kombëtar të Kosovës shënuan këtë ditë edhe këtë vit me aktivitete të ndryshme me temat qendrore “Muzetë si hapësira kulturore / E ardhmja e traditës”. Aktivitetet e zhvilluara patën qëllim angazhimin dhe edukimin e fëmijëve dhe të rinjve për artin tradicional, të ilustruar në zeje të ndryshme përmes metodave interaktive. Studentët dhe edukatorët e muzeut kanë ndihmuar fëmijët pjesëmarrës në realizimin e punimeve të tyre.

Po ashtu është promovuar edhe libërthi me ilustrime

i shkruar dhe ilustruar nga studentët e Departmentit të Antropologjisë “Aventuare e re e Karlit” si tregim për traditën. Studentët kanë zgjedhur një personazh të njohur e të dashur nga filmi vizatimor “Aventura e Karlit”, për ta bërë pjesë të tregimit për traditën shqiptare. Ngritja e vetëdijes për trashëgiminë kulturore u ndihmon fëmijëve të kenë një sens pozitiv për identitetin e tyre. Lexuesi përmes personazhit të Karlit do të ketë mundësi të gjejë detaje për Eposin e Kreshnikëve, për lahutën, arkën e mikpritjen shqiptare. Po ashtu, lexuesi do të krijojë një ide se çfarë është tradita, si duhet ruajtur e kultivuar dhe si të gjithë ne mund të kontribuojmë në promovimin e saj. Aktiviteti është zhvilluar në kuadër të lëndës “Muzetë dhe ekspozimi i kulturës”, të cilën e ligjëron profesorja Zanita Halimi.



Një numër i madh i prindërve prishtinas kanë sjellur fëmijët e tyre në aktivitetin e organizuar nga Muzeu i Kosovës dhe Departmenti i Antropologjisë


Mbrojtja dhe promovimi i djathit të Sharrit: treguesi (indikacioni) gjeografik

Departamenti i Antropologjisë ka ftuar Dr. François Lerin, nga AIDA (Association internationale pour le développement de l'agroécologie, France) për të prezantuar hulumtimet e tij 2 vjeçare për zhvillimin e treguesit gjeografik të djathit të Sharrit, si një ndër produktet vendore më të njohura të Kosovës, sa i përket vlerave të larta agroekologjike.

Në ligjëraten e tij mysafire, më 13 nëntor 2019, Dr. Lerin diskutoi për metodat e hulumtimit të tij në rajonin e Sharrit, gjegjësisht në 4 mikrorajonet e tij, për testimet e bëra mikrobiologjike, për përmbajtjen nutricionalë, për llojet e florës dhe faunës atje dhe për gjithë praktikën profesionale, ekonomike dhe kulturore të procesit të prodhimit të djathit të Sharrit nga blegtorët lokalë. Sipas tij, djathi i Sharrit me kohë e punë, vullnet e bashkëpunim mund ta arrijë nivelin e produktit me tregues gjeografik. Po, ashtu Dr. Lerin foli edhe për të drejtën intelektuale dhe të pronësisë për raste të tilla, për mundësinë e bashkëpunimit rajonal, për aftësimin e brezave të rinj në fushën e agroekologjisë, për mashtrimin me “produkte” të rrejshme dhe për mundësinë e zhvillimit ekonomik bazuar në agroekologji. U diskutua edhe potenciali i ruajtjes së praktikës pastorale të prodhimit të djathit të Sharrit si trashëgimi kulturore.

Ai krahasoi hulumtimet e tij në Shqipëri, Maqedoni dhe Kroaci, me ato në Kosovë dhe vlerësoi vullnetin e bashkëpunimit nga ana e blegtorëve dhe përfaqësuesve të tyre për të krijuar produkte me tregues gjeografikë.

Pas ligjërates, pati pyetje dhe diskutime të frytshme rreth potencialit të studimit të produkteve me vlera të larta natyrore dhe bashkëpunimit të nevojshëm mes shkencave shoqërore dhe atyre natyrore në këtë drejtim.



"Djathi i Sharrit duhet të ketë indikacion gjeografik", tha profesor Lerin

Bashkëpunimi mes Kosovës dhe Portugalisë në trashëgimi kulturore dhe arkeologji

Në kuadër të programit të shkëmbimit të profesorëve (ERASMUS), Departamentin e Antropologjisë e vizitoi profesori i trashëgimisë kulturore dhe historisë militare, Dr. Sergio Coelho Veludo nga Shkolla e Lartë Politeknike e Edukimit në Porto të Portugalisë. Dr. Coelho Veludo qëndroi një javë (6 deri 11 maj 2019) dhe ligjëroi para studentëve dhe stafit të Fakultetit Filozofik për tri tema: trashëgimia kulturore shpirtërore (jomateriale), politikat e BE-së për trashëgimi kulturore në vendet e

konfliktit dhe trashëgimia kulturore dhe edukimin në rastin e Portugalisë. Pas ligjëratave pati diskutime të frytshme, ku studentët patën mundësi të pyesin për aspekte të veçanta të rasteve studimore dhe argumenteve të dhëna.

Gjatë qëndrimit të tij ai iu bashkua edhe ekspeditës njëditore në Muzeun e Mitrovicës së bashkë me stafin dhe studentët e antropologjisë dhe vizitoi parkun arkeologjik të Ulpianës dhe Muzeun e Kosovës. Vizita e Dr. Coelho Veludos u mirëprit dhe hapi vull-

netin e tij dhe institucionit të tij për bashkëpunime të reja me Departamentin e Antropologjisë. Mes tjerash, ai potencoi se: “arkeologët e Kosovës dhe Portugalisë mund të bashkëpunojnë në studimin e romanizimit të territoreve të tyre në periudhën antike, sepse shoh shumë ngjashmëri”. Vizitat e ndërsjella të stafit dhe studentëve dhe projektet e përbashkëta do të jenë temat e ardhshme të diskutimit për bashkëpunim mes Shkollës së Lartë Politeknike të Edukimit në Porto të Portugalisë dhe Departamentit të Antropologjisë.



Profesor Sergio Coelho Veludo është një njohës i shkëlqyer i historisë së ushtrisë romake

Njohja me bursat nga programi “Young Cell Scheme”

Më 29 Nëntor 2018, në Departamentin e Antropologjisë u mbajt një sesion informues për bursat e dhëna në kuadër të programit “Young Cell Scheme – EU Scholarship Programme for Kosovo (round XI-XII)” për sektorin e kulturës, respektivisht për bursa për MA në antropologji dhe arkeologji. Sesioni u mbajt nga z. Ezio Benedetti, zyrtar i projektit të financuar nga Bashkimi Evropian. Studentët patën mundësi të dëgjojnë hollësisht për bursat, kriteret dhe të gjitha aspektet e procedurës aplikuese.

Pritet që edhe në vitet në vijim kultura të jetë pjesë e bursave Young Cell Scheme.



Një studente e antropologjisë ka fituar bursën e “Young Cell Scheme” për MA në antropologji kulturore

Bashkëpunimi në mes të Kosovës dhe Francës në fushën e mobilitetit akademik

Në kuadër të programit të shkëmbimeve të stafit akademik dhe studentëve (Erasmus +) në mes të Universitetit të Prishtinës, respektivisht Departamentit të Antropologjisë dhe Université Lumière Lyon 2 (Francë), janë realizuar mobilitete nga profesorë dhe studentë nga të dyja universitetet. Gjatë prillit të vitit 2018, profesor Arben Hajdari qëndroi për një javë në Universitetin Lyon 2 ku mbajti katër ligjërata para studentëve të nivelit Mater të këtij universiteti: Arkeologjia kosovare: një trashëgimi e pasur për ta njohur dhe mbrojtur; Transformimi i vendbanimeve përball kërcënimit të sulmeve barbare : rasti i Kështjellës së Harilaqit; Procesi i urbanizimit të Dardanisë gjatë periudhës romake; Municipium Ulpiana. Gjithashtu gjatë vitit 2018, në Universitetin Lumière Lyon 2, qëndruan për një semestër tre studentë të programit të arkeologjisë.

Gjatë tetorit të vitit 2018 në Departamentin e Antropologjisë qëndroi për 10 ditë Prof. Dr. Jean-Luc Lamboley, profesor në Universitetin Lumière Lyon 2 ku para studentëve dhe stafit të Departamentit mbajti ligjëratat: Transformimet urbane në qytete-shtete greke; Apolonia e Ilirisë; Organizimi urbanistik sipas sistemit Hipodamian. Në kuadër të kësaj marrëveshje shkëmbimi, në Universitetin e Prishtinës kanë qëndruar edhe



Profesori Lamboley duke ligjëruar për procesin e urbanizimit

dy studentë nga Universiteti Lumière Lyon 2, të cilët kanë qenë pjesë e shkollës arkeologjike në Ulpianë.


Në kuadër të bashkëpunimit me Ecole Normale Supérieure, Profesor Arben Hajdari ka qëndruar dy javë në cilësinë e profesorit vizitor në ENS, gjatë muajit qershor 2019, ku me këtë rast para studentëve dhe punonjësve shkencorë të ENS ka mbajtur ligjëratat: Kisha tempull dhe transformimi i qytetit të Ulpianës gjatë antikitetit; Disa mbishkrime epigrafe të publikuara në Kosovë.

“Teoritë antropologjike: hyrje e shkurtër” - një botim i ri nga Departmenti i Antropologjisë

“Teoritë antropologjike: një hyrje e shkurtër” është një libër hyrës i shkruar kryesisht për studentë. Libri ofron një përmbledhje të teorive të ndryshme antropologjike dhe teorive që kanë pasur ndikim në antropologji, duke analizuar dhe diskutuar aspekte të ndryshme të teorive të ndryshme. Ky libër do të jetë libri kryesor në literaturën e studentëve në lëndë obligative “Teoritë antropologjike”.

Libri ka 12 kapituj, parathënien, indeksin dhe bibliografinë. Libri nuk shitet por ofrohet falas për studentë dhe lexues të tjerë në formatin PDF dhe mund të zbarkohet nga uebfaqja e profesor Arsim Canollit, e cila është dhënë më poshtë.

(<http://filozofiku.uni-pr.edu/Personeli/Personeli-akademik/Prof--Ass--Dr--Arsim-Canolli.aspx>)



Laboratori i Antropologjisë Vizuele (8-10 Gusht 2019)

Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit (IAKSA, Tiranë) në bashkëpunim me Departamentin e Antropologjisë (Fakulteti Filozofik, Universiteti i Prishtinës), në kuadër të projektit “Etnografia si urë lidhëse në marrëdhëniet e bashkëpunimit Shqipëri-Kosovë” ka mbajtur punëtorinë “Laboratori i Antropologjisë Vizuale” në Prizren, e cila ka qenë edhe pjesë e festivalit Dokufest. Në kuadër të temës qendrore “Shoqëria në kufi: etnografi vizuale e marrëdhënieve Shqipëri-Kosovë” studentët e Departmentit të Antropologjisë kanë realizuar tre dokumentarë etnografikë, duke bërë dokumentimin vizual të pasojave që ka pasur dhe vijon të ketë kufiri shtetëror në marrëdhënieve mes njerëzve.

Studentë pjesëmarrës në këtë projekt kanë qenë Anduena Halilaj, Lekë Shala, Urtesa Zeneli, Nol Berisha, Shpat Shkodra dhe Yll Bylykbashi. Projekti ka qenë i kordinuara nga Olsi Lelaj, Ervin Kaqiu nga Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studime të Artit (IAKSA, Tiranë) dhe Zanita Halimi (Departmenti i Antropologjisë, UP). Në Laboratorin e Antropologjisë Vizuale, morën pjesë si mysafirë edhe profesorët e Departmentit të Antropologjisë, Arsim Canolli dhe Lumnije Kadriu, duke kontribuar në diskutimet brenda punëtorive.



“Kroni i Gorozhupit” - film etnografik nga Lekë Shala dhe Anduena Halilaj



“Pikturimi i fytyrës: ndërmjet traditës dhe modernitetit” - studim antropologjik

Libri i profesores Drita Halimi-Statovci “Pikturimi i fytyrës në Kosovë: ndërmjet traditës dhe modernitetit” ofron të dhëna për pikturimin e nuses në Kosovë. Libri është i bazuar në hulumtime në terren dhe shoqërohet me fotografi. Autorja është përpjekur që pikturimin e fytyrës, të njohur si teleisje të nuses, mos ta lë jashtë vëmendjes së shkencës. Libri trajton tema të ndryshme: procesi i pikturimit të fytyrës, kush pikturone, si zbatohej dhe për kë zbatohej teleisja, si përgatitej dhe si sigurohej lënda kozmetike popullore si dhe konteksti i pikturimit.

Botimin e këtij libri e ka mbështetur Departmenti i Trashëgimisë Kulturore/ Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Republikës së Kosovës.



Aktivitete hulumtuese në fushën e arkeologjisë

Në kuadër të aktiviteteve hulumtuese që organizohen nga Departamenti i Antropologjisë, si rezultat i bashkëpunimeve që ka Departamenti i Antropologjisë me institucione vendore dhe ndërkombëtare në fushën e arkeologjisë, profesorë të këtij departamenti kanë realizuar një sërë projektsh hulumtuese arkeologjike në lokalitete të ndryshme arkeologjike në Kosovë (Ulpianë, Harilaq, Korishë, Cernicë dhe Vuçak). Pjesë e këtyre projekteve kanë qenë edhe një numër studentësh nga programi i arkeologjisë dhe antropologjisë kulturore të cilët kanë pasur mundësinë të kryejnë punën praktike dhe të njihen për së afërmi me metodat bashkëkohore që aplikohen në fushën e hulumtimeve arkeologjike.

Hulumtimet ndërdisiplinore në Ulpianë

Projekti arkeologjik në Ulpianë ka disa vite që realizohet në kuadër të bashkëpunimit në mes të Departamentit të Antropologjisë, Institutit Arkeologjik dhe Ecole Normale Supérieure (Francë) nën drejtimin e Arben Hajdari (UP), Milot Berisha (IAK) dhe Christophe Goddard (ENS). Në kuadër të këtij projekti realizohen hulumtime ndërdisiplinore në fushën e kërkimeve arkeologjike. Edhe këtë vit u organizua shkolla verore arkeologjike me pjesëmarrjen e studentëve vendorë dhe ndërkombëtarë, të cilët, pos aplikimit të njohurive teorike të fituara në punën praktike, u njohën edhe me qasjet e reja ndërdisiplinore dhe rëndësinë e tyre në hulumtimin dhe interpretimin arkeologjik. Pjesë e projektit ishin edhe një numër i studenteve të programit të arkeologjisë dhe antropologjisë kulturore.



Profesori Arben Hajdari duke mbikëqyrur punën e studentëve në parkun arkeologjik të Ulpianës



Prof. Goddard dhe studentët në gërmim në Ulpianë

Hulumtimet arkeologjike në Cërnicë të Gjilanit

Projekti arkeologjik në vendbanimin e Cërnicës i filuar në vitin 2016, realizohet nga Instituti Arkeologjik i Kosovës nën udhëheqjen e profesor Sedat Baraliut dhe Premtim Alaj. Vendbanimi i Cërnicës i takon Periudhës së Hekurit dhe asaj Helenistike. Në këtë projekt marrin pjesë edhe studentë të Departamentit të Antropologjisë.



Studentët si pjesë e ekipit që ka gërmuar dhe gjetur evidenca të reja mbi dardanët në lokalitetin Cërnicë

Hulumtimet arkeologjike në Harilaq

Projekti arkeologjik në kalanë e Harilaqit (Fushë Kosovë) realizohet nga Instituti Arkeologjik dhe bashkëdrejtohet nga profesor Arben Hajdarit. Në vitet e fundit, krahas hulumtimeve arkeologjike janë duke u realizuar edhe konservime dhe restaurime arkeologjike me qëllim të mbrojtjes dhe ruajtjes së saj, në radhë të parë, por edhe në funksion të promovimit dhe zhvillimit të turizmit arkeologjik. Në këto punime, krahas profesionistëve të ndryshëm, kanë marrë pjesë edhe një numër i studentëve të Departamentit të Antropologjisë, të cilët kanë pasur mundësi që të njehen me procesin e dokumentimit, konservimit dhe restaurimit të strukturave arkitektonike dhe materialit të lëvizshëm arkeologjik.



Dokumentimi nis me matjet - studentët në praktikë në Harilaq



'Planifikimi i sërveimit dhe gërmimeve në Harilaq' - studentët e arkeologjisë në praktikë

Hulumtimet arkeologjike në Korishë

Projekti arkeologjik në Korishë të Prizrenit ka filluar në vitin 2016, nën udhëheqjen e profesor Pleurat Kabashit. Ky projekt financohet nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe nga Komuna e Prizrenit, dhe realizohet nga Instituti Arkeologjik i Kosovës. Projekti realizohet në dy vendgërmime: në Kalanë e Gralishtës dhe në vendbanimin romak. Në këtë projekt kanë marrë pjesë edhe arkeolog ndërkombëtarë, si Jean-Luc Lamboley (Francë), Polly Lohmann (Gjermani), Altin Skënderaj dhe Brikena Shkodra (Shqipëri). Po ashtu, pjesë e këtyre gërmimeve kanë qenë edhe një numër i madh i studentëve të Departamentit të Antropologjisë.



Studentët e arkeologjisë në gërmime në Korishë

SEMINARI

Seminari i Antropologjisë synon avancimin e mendimit të lirë dhe diskutimit kritik antropologjik përmes ligjëratave, tryezave dhe aktiviteteve tjera shkencore e profesionale. Qëllimi kryesor i këtij Seminari është të organizojë ligjërata mysafire me studiues të antropologjisë kulturore, arkeologjisë, historisë dhe shkencave tjera shoqërore e dijeve humane dhe të hapë mundësi për dialog, diskutim e njohje mes studiuesve të këtyre fushave. Seminari i Antropologjisë udhëhiqet nga stafi i Departamentit të Antropologjisë. Gjatë vitit akademik 2018/2019 janë planifikuar dhe realizuar 9 ligjërata mysafire, të cilat janë pasqyruar në këtë rubrikë. Për kalendarin e vitit akademik 2019-2020, shih faqen 32.



1. Shtetësia, ndasia dhe lëvizjet sociale



Më 25 tetor 2018, në kuadër të Seminarit të Antropologjisë, u mbajtë ligjërata e parë me temë “Shtetësia në shtete të ndara në kontekst të lëvizjeve sociale: rasti i Maqedonisë” ku prezantoi temën e saj të doktoratës, politologja Lura Pollozhani nga Qendra për Studime të Evropës Juglindore në Universitetin e Gracit në Austri. Lura diskutoi për lëvizjet sociale dhe qytetarinë aktive në kontekst të Maqedonisë, duke paraqitur metodat, qasjet dhe teoritë kryesore të cilat përshkruajnë studimin e saj. Prezantimi nisi për “qytetarinë”

(citizenship) dhe kuptimet e këtij koncepti në një shesh empirik që synon të kapërcejë etnicitetin fanatik, por dhe multikulturalizmin banal, duke i parë ato në kontekst të lëvizjeve sociale.

Ligjërata vazhdoi me prezantimin e metodave të realizuara, ku u fol edhe për “vrojtimin me pjesëmarrje”. U fol për peshën e kësaj metode në antropologji të politikës apo antropologjinë politologjike, mundësitë dhe pamundësitë, sfidat dhe dilemat e realizimit të saj në kontekst të hulumtimit empirik. Lura diskutoi

edhe për pozitën e antropologes/politologes si hulumtuese “në shtëpi të vet” dhe sfidat e studimit akademik në kushte të stereotipizimit të shumëfishtë. Po ashtu, Lura nxori në syprinë edhe kontekstin teorik të argumentit për “lëvizjet sociale” në bashkëkohësi dhe potencoi synimin e saj për kontribut original në persiatje teorike mbi këtë temë.

Pas prezantimit, pati pyetje dhe komente të shumëta nga studentët dhe kolegët, si për temën specifike ashtu edhe për temat tjera që ky prezantim cyti.

2. Sfidat e përpilimit të teksteve të historisë

Më 29 nëntor 2018, në kuadër të Seminarit të Antropologjisë, u mbajt ligjërata e dytë nga Prof. Ass. Dr. Arben Hajdari dhe Dr. Sedat Baraliu (Departamenti i Antropologjisë), të cilët diskutuan mbi temën “Sfidat e përpilimit të teksteve shkollore: rasti i tekstit të historisë për klasën 6”

Gjatë kësaj ligjërata u diskutua për tekstet shkollore të lëndës së historisë dhe sfidat e përpilimit të teksteve të reja. Në kuadër të këtij diskutimi profesorët e Departamentit të Antropologjisë, Dr. Arben Hajdari dhe Dr. Sedat Baraliu theksuan disa probleme me frymën dhe narracionin e disa teksteve shkollore të lëndës së historisë. Po ashtu u diskutua edhe sfida e krijimit të modelit më të mirë për tekst shkollor bazuar në hulumtimet në fushën e edukimit, specifikisht në atë të përpilimit të kurrikulave.

Gjatë diskutimeve, u poten-



cua nevoja për hulumtime të thella në mënyrën e shkrimit të narracionit historik, përzgjedhjes së shembujëve, ilustrimeve dhe gjithë aspektit të

përpilimit të një teksti didaktik për mësimin e lëndës së historisë në moshën përkatëse.

3. Antropologji e kulturës buknore

Më 27 dhjetor 2018, u mbajt ligjërata e tretë e Seminarit nga Prof. Ass. Dr. Arsim Canolli (Departamenti i Antropologjisë), ku u promovua libri i tij “Flija: vërtet etnografik”. Në promovim të librit mori pjesë profesor Nebi Bardhoshi, drejtor i Institutit të Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit, Tiranë, njëherish edhe botues i librit.

Dr. Canolli foli për sfidat e kërkimit dhe shkrimit të një monografie për një temë specifike dhe të “imët” si është kultura buknore, e në kontekst të saj për një gatesë/haje të veçantë si “flija”. Ai diskutoi për qasjet e studimit, metodat dhe kontekstin teorik, të ngjeshur në studimin e tij. Gjatë ligjërates hyrëse, ai veçoi synimin e tij për të paraqitur dimensione të ndryshme sociale e kulturore, të cilat manifestohen në



përgatitjen, shkëmbimin, konsumin dhe ekspozimin e flisë si haje ikonike e Kosovës. Ai foli për punën e tij në terren, për kontekstin e studimit të kulturës së bukës në kuadër të studimeve antropologjike dhe për nevojën e zgjerimit të hulumtimit specifik historik në temën e kulturës

së bukës (apo historinë kulinare).

Pas ligjërates pati një diskutim të frytshëm për qasjet e studimit, aspektin historik dhe antropologjik të studimit të temave të njohura si “tema të vogla” dhe nevojën për etnografi të “së kaluarës në të tashmen e përditshme”.

4. “Nuk ka arkeologji pa bashkëpunim ndërkombëtar”



Më 17 janar 2019, u mbajt ligjërata bashkëpunimin e nisur pikërisht në e katërt nga profesori i arkeologjisë së gjermimit arkeologjike në Ulpianë, dhe historisë antike, Dr. Christophe Goddard, me temë “Ndërtimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit arkeologjike mes Francës dhe Kosovës/ Building bridges in archaeology: the case of France and Kosovo. Dr. Goddard vjen nga Qendra Kombëtare Franceze për Hulumtime Shkencore (CRNS/ENS), një institucion elitare i studimeve të avancuara në shkenca shoqërore dhe dije humane në Francë.

Tema e ligjëratës përfshiu paraqitjen e sistemit të studimeve të larta në Francë, mundësitë për bursa për studentët kosovarë të arkeologjisë dhe antropologjisë kulturore, bashkëpunimin mes CRN, Departamentit të Antropologjisë dhe Institutit Arkeologjik të Kosovës në gjurmimet arkeologjike në parkun arkeologjik të Ulpianës. Profesor Goddard foli edhe për historinë e bashkëpunimit të gjeneratave të ndryshme të arkeologëve të Francës dhe Kosovës, duke theksuar

menjëherë pas luftës.

Në ndër sintagmat kryesore të u theksuan në këtë ligjëratë ishte edhe theksi te bashkëpunimi ndërkombëtar. “Nuk ka arkeologji pa bashkëpunim ndërkombëtar”, tha profesor Goddard. Ekipet e gjurmimit arkeologjik, por edhe ato të analizave e interpretimit, përbëhen prej një numri të madh të profesionistëve të fushave të ndryshme, duke filluar prej kimisë e arkeobotanikës e deri te fotografinë e animacionit 3D. Një vend i vogël si Kosova e ka të vështirë të zhvillojë studimin arkeologjik pa bashkëpunime. Por, profesor Goddard theksoi edhe bashkëpunimet ndërdisiplinore, si të frytshme në studimet arkeologjike. Sipas tij, bashkëpunimi mes arkeologjisë dhe antropologjisë kulturore është më se i nevojshëm dhe jashtëzakonisht frytdhënës në interpretimin arkeologjik. Profesor Goddard njoftoi studentët e kolegët pjesëmarrës edhe për idenë

e përbashkët (mes CRNS dhe Departamentit të Antropologjisë, Fakulteti Filozofik) për të përpiluar një kurs të përbashkët postdiplomik (MA) në arkeologji dhe antropologji, me fokus në trashëgiminë kulturore. Ky program është në fazën fillestare propozuese. Përmes këtij kursi studentët do të kishin mundësi të studiojnë në Francë dhe në Kosovë së bashku me studentët francezë, të cilët po ashtu do të kishin mundësi të studiojnë (sidomos në anën praktike) në Kosovë.

U theksua, po ashtu, se qeveria franceze, përmes ambasadës së saj, jep bursa specifike të nivel MA dhe PHD në fushën e antropologjisë, arkeologjisë e historisë antike, për studentët kosovarë, të cilët kalojnë prapë në testin e gjuhës frënge dhe kanë nota të mira. Deri tani dhjetëra studentë kosovarë kanë marrë bursa studimore për studime MA dhe PHD në Francë.

Ligjërata u mirëprit shumë nga pjesëmarrësit dhe pati diskutim të gjatë rreth temave të ngritura.

5. Një studim i etnologjisë nën diktaturë



Më 28 shkurt 2019, në ligjëratën si “kopsht” që duhet kultivuar ara dhe të pashkruara të etnologëve që e pestë në kuadër të Seminarit me planimetri strikte ideologjike, kanë punuar gjatë asaj periudhe, e me të Antropologjisë, u promovuar për shkencën etatiste dhe etikën e radhë.

libri “Etnografi në diktaturë: dija, shteti dhe holokausti ynë” (2018) nga antropologët Dr. Nebi Bardhoshi dhe Dr. Olsi Lelaj, bashkëautorë të librit, të botuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Autorët janë hulumtuesë shkencorë pranë Institutit të Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit, Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë.

Dr. Bardhoshi dhe Dr. Lelaj folën për dijen etnografike të prodhuar në kushte të diktaturës komuniste, për raportin epistemologjik të etnografisë dhe albanologjisë së prodhuar në kushte strikte të ideologjisë shtetërore, për konceptet e shtetit modern racionalist që shoqërinë e planifikon

totalitarizmit etatist e shumë tema tjera të cilat ndërlidhen me etnografinë në veçanti dhe dijen shkencore shtetërore në Shqipërinë enveriste në përgjithësi. Ligjërata erdhi si një grishje inspiruese për leximin e librit të dalë nga një punë 10 vjeçare hulumtuese e studiuesve Bardhoshi dhe Lelaj, si një kërkim historiografik në fushën e zhvillimit të dijes shkencore etnografike në diktaturë, i mbrumur nga pikëpamja e antropologjisë historike. Autorët folën edhe për temat specifike të studimit të tyre, si sfidat e kërkimit arkivor në “dokumentacionin faktik” institucional, kujtesën autoriale të etnologëve shqiptarë, përvojat e shkru-

Pas ligjëratës pati pyetje, komente e dialogje të thukëta mes autorëve dhe profesorëve të antropologjisë, historisë, sociologjisë dhe studentëve të këtyre departamenteve të Fakultetit Filozofik.

6. Teoria në arkeologji: diskutime të reja



Në kuadër të Seminarit të Antropologjisë, më 28 mars 2019, u mbajt ligjërata e 6 e radhës “Teoria në arkeologji: diskutime të reja në fushën e mendimit arkeologjik” nga Dr. Esmeralda Agolli, profesore e arkeologjisë dhe trashëgimisë kulturore në Universitetin e Tiranës.

Dr. Agolli dha një panoramë të mendimit teorik në fushën e arkeologjisë, duke theksuar indiciet e para të teorisë në arkeologji në antropologjinë evolucioniste dhe difuzioniste, por duke u ndalur te rryma e mendimit historik-kulturor në arkeologji dhe rryma procesualiste në punë e Lewis Binford-it, një prej prijatarëve të mendimit procesualist në arkeologji, mendim ky që ka afruar arkeologjinë me antropologjinë.

Po ashtu, Dr. Agolli foli edhe për kritikën postprocesualiste të Ian Hodder-it e Chris Tilley-it dhe theksoi

ndeshrashjen mes këtyre dy teorive, por edhe sfidat metodike të teorisë postprocesualiste.

Gjatë diskutimeve, Dr. Agolli reflektoi shkurtazi edhe për mendimin teorik në traditën e arkeologjisë shqiptare dhe hapjen e diskutimeve të reja në konversacionin arkeologjik shqiptar sot. Në përgjithësi, gjatë diskutimeve u potencua se arkeologjia shqiptare është ende në dialog fillestar me teoritë arkeologjike, si në kontekstin procesualist, ashtu edhe në atë postprocesualist, por edhe në kontest të teorive të ndryshme bihejvioriste. Fakti se në periudhën e komunizmit, teoria ka qenë e kurditur të jetë sipas mendimit historiko-kulturor, ka krijuar një lloj epistemologjie specifike në interpretimin e së kaluarës materiale.

Gjatë diskutimeve u potencuan sfidat e kërkimeve të sotme në

arkeologjinë shqiptare dhe nevoja për bashkëpunime të mëtutjeshme në këtë fushë mes Tiranës dhe Prishtinës.

7. Djathi i Sharrit: produkt i dashurisë



Në kuadër të Seminarit të Antropologjisë, më 27 prill 2019, u mbajt ligjërata e shtatë dhe u promovua katalogu “Djathi i Sharrit: produkt i dashurisë mes maleve të Sharrit dhe Prizrenit” nga Rina Geci, studente postdiplomike në Departamentin e Etnologjisë dhe Antropologjisë kulturore në Universitetin e Zagrebit.

Rina Geci foli për etnografinë e realizuar mbi prodhimin dhe konsumin e djathit të Sharrit, duke ofruar një pamje të shkurtër të shtigjeve tematike të cilat i ka rrahur në studimin e saj. Ajo paraqiti specifikat ekologjike të malit Sharr, florës dhe faunës, praktikën e përpunimit të djathit, jetën sociale të djathëpunuesve, raportet ndërkulturore në krahinën e Opojës dhe Gorës dhe aspekte tjera të ekonomisë familjare në kontekst të transhuncës në përgjithësi.

Pas ligjëratës, në kuadër të pyetjeve

të shumëta nga audienca, u diskutua edhe për djathin e Sharrit si artefakt buknor, konceptin “terroir”, politikën e brendimit, identitetin rajonal, aspiratat trashëgimuese, raportet ndëretnike, etj.

Po ashtu, ajo foli edhe për sfidat e hulumtimit, punën në terren dhe potencialin e temës për studime të mëtutjeshme. Katalogu është botuar nga organizata “Trashëgimia kulturore pa kufij”, si projekt i programit “Heritage Space” në vitin 2017.

Ligjërata u mirëprit si një shteghapje për studime të mëtutjeshme në kuadër të antropologjisë së kulturës buknore në përgjithësi.

Aktualisht Rina Geci është duke përfunduar hulumtimet antropologjike mbi kulturën e ullirit në Ulqin të Malit të Zi, në kuadër të temës së diplomës (MA) në etnologji dhe antropologji kulturore.

8. Gjuha dhe survivancat latine



Më 30 maj 2019, u mbajt ligjërata e tetë me radhë e Seminarit të Antropologjisë, ku ligjëroi Dr. Evalda Paci, hulumtuese në Departamentin e Studimeve Letrare, në Akademinë e Studimeve Albanologjike, Tiranë. Dr. Paci ofroi një pamje të emrave, fjalëve, toponimeve, proverbave dhe gjuhës latine në përgjithësi, si hyrje të njohjes së botëkuptimit politik, kulturor e shoqëror në botën antike romake.

Ajo foli për veprat e ndryshme të shkrimtarëve romakë, për survivancat e ndryshme në variante të gjuhëve evropiane, ku bën pjesë edhe gjuha shqipe. Po ashtu, u diskutua edhe për rëndësinë e njohjes së latinitetit për studimet shqiptare, si në fushën e gjuhësisë, ashtu edhe në atë të antropologjisë. Aspekte të caktuara të praktikave të ndryshme politike e ligjore manifestohen në shkrimtarinë latine, të cilat pastaj

janë shndërruar në “survivanca” në gjuhën shqipe, por edhe në forma të ndryshuara gjatë kohës.

Pas ligjërates pati një diskutim të frytshëm për peshën e studimeve klasike, në formimin e studiuesëve të fushës së arkeologjisë e antropologjisë.

9. Ndryshimi i tregimit



Më 6 qershor 2019, në kuadër të Seminarit të Antropologjisë, u mbajt ligjërata e 9-të dhe e fundit për këtë vit. Ligjërata që një përmbledhje e punës në projektin ndërkombëtar “Ndryshimi i tregimit/Changing the Story”, në të cilin merr pjesë edhe Universiteti i Prishtinës, respektivisht profesorja e Departamentit të Antropologjisë, Dr. Nita Luci dhe disa studentë të departamentit. Ajo foli për etnografinë dhe hulumtimin pjesëmarrës e participues në kuadër të projektit, ku shpalosi punën e deritanishme të këtij projekti në Kosovë, gjegjësisht aktivitetet e realizuara në pesë komuna të saj me organizata të rinjëve dhe artistëve.

Dr. Luci shpjegoi qëllimet e projektit, metodat dhe kornizën teorike dhe disa nga produktet e krijuara nga pjesëmarrësit në këtë projekt. Ai theksoi se projekti do të vazhdojë edhe në vitet e ardhshme. Synimi i projektit, me sa u theksua gjatë ligjërates, duket

të jetë ndryshimi i mendimit ekzistues mbi qytetarinë aktive dhe artin në Kosovë, përmes krijimit të modeleve të dijes specifike, të artikuluar si “mendim kritik për qytetarinë aktive”, të cilat mund të jenë modele të aplikueshme në të ardhmen. Si projekt ndërkombëtar, i realizuar në pesë shtete të botës (Ruandë, Kolumbi, Afrikë e Jugut, Kosovë, Kamboxhë), ideja e projektit u theksua si ide që përmes antropologjisë të intervenohet në ndryshimin e tregimit historik, artistik, politik, që është dominant në këto shoqëri, të cilat kanë kaluar nëpër luftëra e konflikte.

Pas ligjërates pasoi një debat ku pati pyetje dhe u komentuan disa gjëra relevante si: raporti i antropologut me objektin e studimit, nevoja dhe refuzimi i intervenimit të antropologut, qasja (jo)terapeutike, etnografia militante, (mos)ndikimi i projektit në realitet, etj.

Amëlsia e terrenit

(nga Besjana Rrahmani,
studente e antropologjisë kulturore, 6 maj 2019)

Kësaj here amëlsia filloi nga stomaku e shpërndahej nëpër terrenin e dijes. Sikurse fillon zbulimi i një pjate të re të gatimit ashtu edhe vetë studentat filluan të zbulonin pjatën e tyre të njohurisë mbi Hasin, vendin ku ishin përcaktuar të kalonin ditën.

Kështu edhe filloi udhëtimi ynë i shkurtër njëditor, një sfidë e re për të ngopur veten e duke mos e lënë asnjë *kashore* të pangrënë rrugëve të njohjes antropologjike. Udhë drejt Hasit nxori në pah vetëm reflektimet e fytyrave tona mbi ato xhama që na rrethonin ngado e nuk na linin më shumë hapësirë veçse të udhëtonim në mendjen tonë. Megjithatë ishte një kohë mëse e përshtatshme për të filluar me biseda të përditshme, biseda që as nuk besoj se do t'i flisnim ndonjëherë në universitet. E habitshme!

Aroma e bukës na kishte përcjellur deri tek furra e fshatit. Përpjekja për të gjetur gjuhën e përbashkët, atë të bukës, i futi në kurth studentët për një interaksion të



Shtëpia rozë në Zym

përditshëm me punëtorët e furrës, ato vajza që të falnin ndjenjën e parë të traditës buknore të asaj rrethine të njohur për *zanatin e bukëpjekësve*. Theksi i tyre të kujtonte vetë Hasin.

Lezet i burekut i forconte e udhëhiqte bisedat e më-tutjeshme të grupit deri në kthimin prapa në automjet ku kishim për të vazhduar edhe një *copë* rruge për në fshatin Zym.

Pasi kaluam malet e lumin Drin, më në fund ishim brenda *hullisë së katunit*. Pastaj, ndaluam para një shtëpie ngjyrë rozë. Nuk di si, por kombinimi i ngjyrës së saj me ngjyrën e qiellit i dhanë ngjyrë atij momenti.

Para nesh qëndronte padija për këtë arkitekturë të katunit. Vërehej një laramani e asaj *katunopikës* dhe qyte-tares, dy shtresa që i ndante një fije peri. Sepse ishin mbuluar nga petku i sjelljes së mirë! Vërehej një zymtësi e madhe brenda asaj hapësire të gjerë autentike, por ndoshta hija e atyre buzëqeshjeve kalimtare e fshihte këtë mistifikator regional. Pak fëmijë endeshin rrugëve, sepse mësimi kishte përfunduar. Një grup i tyre ishin tubuar tek një shkëmb. Para bustit të Skënderbeut, disa gra ishin ulur dhe pinin kafën e tyre të mëngjesit. Dukej si një mëngjes heroik!

Udhërrëfyesja jonë zonja Lajde Kolgjeraj kishte vendosur të na përcillte gjatë këtij rrugëtimi etnografik. Dukej sikur meloditë e kabanave të kishës na drejtonin vetë nëpër rrugët e ngushta të këtij terreni. Një melodi e kompozuar bukur, por që mbante mbas vetes një zhurmë të vetmuar.

Me fillimin e ekspeditës në brendi të fshatit, njëri nga



Muzeu i Zymit

shumë vendet që kemi vizituar ishte edhe muzeu i brishtë i këtij rajoni. Zonja Lajde na prezantoi një pasqyrë të mjegullt të asaj hapësire të harruar. Në hyrje të këtij muzeu mund të vëreje një organizim të çrregullt të objekteve dhe artifakteve të asaj hapësire pa dimensione artistike. E vetmja gjë që i jepte rrëfim dhe ngjyrë ishin posterët e ngjitur mbi mure me figura legjendare dhe historike. Por pa harruar këmbëngultësinë mund të vëreje se vetë shpresa e zonjës Lajde i jepte një lloj gjallërie kësaj dhome historike. Aty gjendeshin disa mjete të rralla, përdorimin e të cilave nuk e kuptova në shikim të parë. Megjithatë, vetë vjetërsia e tyre e *hijeshonte* ambientin.

Përveq hapësirave muzeale dhe historikut të tyre, nuk mund t'i rezistojë edhe atmosferës së shenjtë kishtare që mbizotëronte mbi këtë rajon. Atë mund ta vëreje ngado që silllesh, qoftë në monumentet e ngritura rrugëve, qoftë në bukuritë e shenjta kishtare. Ne vizituam edhe njërin nga kishat më të njohura të fshatit. Një prezantim i një atmosfere më ndryshe sesa herave të tjera. Dhe, mbi të gjitha, një befasi e këndëshme, të shohësh sesi arti ishte derdhur në funksion të kombit. Kjo kishë kishte bërë gërshetimin e figurave të shenjta kishtare me ato heroike kombëtare. Një atribut shumë humanitar dhe me vlerë të madhe artistike, pse jo edhe kombëtare!

Mbresë të madhe, që nuk harrohet, më ka lënë edhe dhoma e veshjeve të ndryshme popullore të mbledhura nga zonja Lajde. Ajo kishte një koleksion pak të njohur nga etnologët tanë. Unë do ta quaja atë *arka e veshjeve popullore*. U gëzova që u njoha me veshjet dhe elementet e saj, që i japin karakteristike veçuese kësaj krahine etnografike. Me larminë e saj të begatshme në pikëpamje strukturale, morfologjike dhe ornamentike.

Gjatë punës tonë në Zym u njoftuam edhe me dy vende simbolike të kësaj rrethine. Së pari me shtëpinë përku-



Arkat plot veshje në shtëpinë e zonjës Lajde Kolgjeraj, Zym

jtimore të Katarina Josipit, artistes së madhe. Dhe me varrin përkujtimor të At Shtjefën Gjeçovit. Por, jo gjithmonë rastësitë qëllonjë të habitshme, për faktin se gjatë vizitës në kompleksin e varrezave hasëm edhe me varrin e shkrimtarit tonë të dashur Anton Pashkut. Asnjëherë nuk e kisha menduar se do të vinte dita kur do të më kujtoheshin rreshtat e tij nga romani 'Oh'. Jo çdo autor ushqen kujtesën tonë me veprat e tyre të pavdekura, por mesa duket, Pashku ia ka arritur këtij qëllimi tashmë!

Dhe, dalëngadalë po i afroheshim manifestimit të cilin e kishum pritur gjatë tërë ditës: Festivalin etnokulturo-r 'Hasi Jehon'. Ky festival u mbajt në fshatin Gjonaj të Hasit. Dukej se më në fund po gjenim pikënisjen kryesore



Foto nga festivali "Hasi Jehon" 2019, Gjonaj

të këtij udhëtimi.

Gjithkund njerëz të rinj e të reja, pleq e të vjetër. Sikur i gjithë Hasi po përgatitej për këtë ditë që kishin gjetur vendtakimin e përbashkët. Por nuk ishin vetëm njerëzit që hidhnin valle. Edhe malet edhe fushat po vallëzonin bashkë me ta. Shija, dija, ndjenjat, ngjyrat dhe sharmi i kësaj dite u bashkuan në Gjonaj.

Nuk mund të harroj as ato fytyra të reja e të vjetra që bënë dritë si *hana natën kur rrezon*. Dhe, mbi të gjitha vërehej se në esencë këta njerëz që kishin ardhur edhe prej trojeve të tjera të largta, krejt çfarë i bashkonte atë ditë ishte vetë *dashuria për atdhe* e asgjë më shumë.

Në shikim të parë veshjet hasjane dukeshin të hijshme që nga koka gjerë tek këmbët. Por edhe nga syri antropologjik dhe artistik ato veshje paraqitnin një rrugë plotë kolorit për studim të mëtutjeshëm. Vetë nuancat e materialeve tërhiqnin vëmendjen e shtegtimin mbi traditën dhe identitetin kulturor. Afër meje, ekspozohej një atmosferë shumë familjare. Gjithë ai familjaritet ngrihej mbi notat e muzikës e harmonisë së valleve.

Një ditë në Isniq

(nga Urtesë Zeneli,
studente e antropologjisë kulturore, 6 maj 2019)

Puna në terren përbënë njërën nga shtyllat kryesore të antropologjisë, përmes së cilës, studiuesi përmbledh evidenca empirike dhe mëson se si të përballohet me të papriturat që dalin. Puna në terren e kompletton dhe e mishëron të gjithë punën teorike të bërë paraprakisht nga studiuesi rreth një teme të caktuar. Pra, pasi që konceptohet metodologjia, qasjet dhe teoritë e ndryshme, antropologu duhet të bëjë një planifikim paraprak të qasjes dhe metodës që do ta zbatojë përgjatë hulumtimit të tij në terren. Megjithatë, varësisht prej rrjedhës së ngjarjeve në terren kjo metodë e antropologut mund edhe të ndryshoj dhe duhet shikuar se cila prej metodave i përshtatet më së miri në mënyrë që të marr sa më shumë informacione dhe të njëjtën kohë të jetë i pranueshëm edhe në aspektin moral apo etik.

Vizita njëditore në fshatin Isniq ishte hera e dytë e përvojës sime së punës në terren. Edhe pse ishte vetëm vizitë njëditore unë përfitova shumë njohuri dhe informacione të reja dhe gjithashtu përjetova të punuarit në praktikë për të mësuar se si bëhet studimi empirik.

Së pari, para ditës që do të bëhej vizita, unë bëra një përgatitje të mjeteve dhe gjithashtu po shqyrtoja se cilat metoda do t'i përdorja në këtë vizitë njëditore. Fatkeqësisht, unë nuk kisha lexuar asnjë libër për të mësuar më shumë rreth historisë së fshatit Isniq apo edhe për tu njohur me gjend-



Në Kosovë kaqindra dhjetëra kulla autentike

jen aktuale. Gjithashtu, për arsye se unë nuk kisha ndonjë teori paraprake për këtë fshat dhe banorët e saj në mënyrë që ta vërtetoja përmes hulumtimit tim në këtë vizitë, unë vendosa që të përdorë metodën induktive (nga poshtë – lartë) për hulumtimin tim. Përmes kësaj metode antropologu, i cili bënë vëzhgim me pjesëmarrje në një vend të caktuar, do të merr sa më shumë informacione dhe evidenca të ndryshme dhe prej kësaj mbledhjeje të dhënave, antropologu jep hipoteza apo teori përfundimtare. Ndërsa sa i përket mjeteve për të marr informacione dhe evidenca, unë vendosa të marr aparatin tim fotografik, Canon modeli Rebel T3, për të bërë foto dhe për të inçizuar dhe gjithashtu vendosa të marr një fletore të vogël për shënime shitesë.

Të nesërmen në mëngjes unë, profesorët dhe kolegët e mi arritëm në fshatin Isniq. Pejzazhi i fshatit ishte mjaft bukur dhe i thjeshtë si shumë fshatra shqiptare. Kishte shumë gjelbërim, ajri ishte i lehtë dhe i pastër si dhe mbizotëronte një qetësi konstante gjithandej. Në këto momente të shijimit fillestar në fshatin Isniq, fatëkeqësisht aparati im fotografik nuk po funksiononte për shkak të ndërrimit të kartës memoriale. Sinqerisht, u bëra pak nervoz dhe më erdhi inat! Mirëpo, nga ky gabim unë morra mësim që sa herë të kem punë në terren gjithmonë duhet bërë prova paraprake të shumta me aparat në mënyrë që të sigurohem se po funksionon. Pasi mbeta pa aparat unë kërkova ndihmë nga kolegja ime Besjana duke e pyeturur se a mund ta përdor herë pas

here telefonin e saj për të marr evidencë. Ajo pranoi.

Pasi vizitua pak qendrën e fshatit, ne të gjithë u ndalua në kullën e familjes Kukleci. Kulla ishte shumë e bukur dhe tipike shqiptare, e ndërtuar prej guri dhe druri.

Mbikqyrja e kësaj kulle ishte në dorë të zonjës Burbuqe Kukleci, ndërsa e zonja e shtëpisë ishte halla e saj zonja Time. Të dyja jetonin në këtë kullë dhe po ashtu e ruanin kullën si një pasuri trashëgimore shqiptare. Kjo kullë ishte e ndarë në dy pjesë dhe sipas zonjës Burbuqe kjo ndarje kishte ndodhur në kohën kur babgjyshi i saj (përafërsisht rreth viteve të 60-ta) kishte pasur dy gra dhe numri i antarëve të shtëpisë ishte rritur shumë dhe kështu u ndërtua edhe pjesa tjetër e kullës. Zonja Burbuqe gjithashtu na tregonte se si gjatë luftës së fundit në Kosovë, kulla ishte dëmtuar në skajin e kulmit të saj, mirëpo pas luftës dikur në vitin 2001, ajo u renovua nga organizata CHwB. Sa i përket pjesës së brendshme të kullës, mua fillimisht më bënë përshtypje shkallët e drurit të cilat ishin të ndërtuara në formë shumë vertikale në mënyrë që të kursejnë më shumë vend apo hapësirë pasi që kulla ishte e ndërtuar ngushtë. Pas kësaj, unë dhe kolegët e mi, mësuam fjalë të reja që janë përdorur për të përshkruar pjesë të ndryshme të kullës si: qilere, dyshekllap, divahane, çerka e madhe dhe çerka e vogël etj.

Pas vizitës së kullës së familjes Kukleci, ne të gjithë shkua që të vizitojmë shtëpinë e kolegës sime, Çlirimtares, ku babai i saj zoti Miftar Januzaj kishte themeluar muzeun e tij privat "Etno-Kastrioti". Ky muze ishte shumë i pasur dhe përmbante një koleksion me rreth 1000 artefakte të periudha të ndryshme.

Prej gjithë këtyre artefakteve, mua më së shumti më bëri përshtypje guri i energjisë, siç e quante zoti Miftar,



Muzeu i shtëpisë është muze i dashurisë



Pajtimi është fisnikëri

gur ky i cili i përkiste periudhës së neolitit dhe gjithashtu zoti Miftar na tregonte me shumë pasion se si ky gur i kishte jepur një energji të jashtëzakonshme në momentin që e kishte prekur atë për herë të parë.

Pas kësaj vizite të këndëshme në shtëpinë e zotit Miftar, ndalesa jonë e radhës ishte në kullën e familjes Osdautaj.

Kjo kullë ishte shumë e veçantë sepse ishte e vetmja kullë e fshatit Isniq e cila ishte trekatëshe. Në këtë kullë na priu një djalë i ri i cili i përkiste familjes Osdautaj. Kulla ishte shumë më e madhe sesa kulla

e familjes Kuklecaj dhe gjithashtu në korridor të katit të fundit ishin të ekspozuara disa foto të bëra nga Ann Christine Eek, e cila ishte kolege e antropologes Berit Becker. Antropologja Berit Becker ishte nga Norvegjia dhe ajo bëri studimet e saja antropologjike në fshatin Isniq, ku përgjatë këtij studimi janë bërë edhe shumë foto nga ajo dhe Ann Christine Eek. Në këtë kullë më bëri përshtypje edhe një simbol i veçantë i cili ishte i vizatuar në përball hyrjes së odës së madhe të burrave.



Kulla ishte simbol qëndrese

e gjakut si dhe një lloj betimi i shenjtë i cili bëhej nga burrat para se të hinin në odën e madhe.

Dhe, si përmbyllje, ndalesa jonë e fundit e kësaj vizite ishte në familjen Sinanaj. I zoti i shtëpisë i cili quhej Gani, na ftoi për në shtëpinë e tij pasi e pa profesorin tonë, i cili e përshëndeti sa ishim duke udhëtuar rrugës. Ai dhe familja e tij ishte shumë mikëpritëse dhe e afërt dhe gjithashtu patëm kënaqësinë që të dëgjojmë historinë e tyre, e cila ishte mjaft e vështirë. Fillimisht zoti Gani dhe gruaja e tij kishin qenë shumë të varfër, ndërsa tani zoti Gani ishte një tregtar i sukseshëm, pastaj ai na tregonte se si gjatë luftës së fundit në Kosovë, shtëpia e tij ishte djegur dhe ishte dëmtuar disa herë, mirëpo me punën e pashterrur të familjës, ata ia dolën që t'i bënin ball që të gjitha vështirësive.

Një tjetër detaj i vogël i cili më bëri shumëpërshtypje, ishte se zoti Gani e quante gruan e tij "burrë" dhe ai na tregoi se e quante kështu për shkak se ajo i kishte ndihmuar jashtëzakonisht shumë me punët e shtëpisë apo me punët e rënda fizike, punë këto të cilat në kulturën tonë tradicionale cilësohen si punë që mund të bëhen vetëm nga burrat.

Kjo ishte përmbledhja apo përshkrimi im përmbledhës i vizitës njëditore në fshatin Isniq.

Një ditë në gërmime


(nga Merita Beqiraj, studente e arkeologjisë e cila ka mbaruar studimet BA në Departamentin e Antropologjisë. Tani vazhdon studimet MA në studime arkeologjike në Hungari, ku ka fituar bursë nga shteti hungarez)

Periodha e gërmimeve arkeologjike është koha kur ne i praktikojmë dijet tona të cilat i kemi nxënë gjatë mësimave mbi arkeologjinë. Rëndësia e gërmimeve në arkeologji është e patjetërsueshme. Përmes gërmimeve dhe me pas duke i studiuar dhe analizuar artefaktet që njerëzit kanë lënë pas ne arrijmë të kuptojmë të kaluarën e tyre.

Gërmimet në një lokalitet arkeologjik zgjasin me vite, ndërsa kuantiteti, lloji dhe intensiteti i punës ndryshon nga dita në ditë. Ato që duhet të mbeten çdo herë të njëjta janë serioziteti, kujdesi dhe ndjeshmëria në gërmim. Procesi i gërmimeve është shumë kompleks dhe përfshinë disa faza si: gërmimin, fotografimin dhe vizatimin e hapësirës së gërmuar; të cilat nuk janë të arritshme të realizohen në një ditë të vetme.

Gjatë rrugëtimit tim në arkeologji, si studente, kam pasur fatin të jem pjesë e shumë ekspeditave arkeologjike në Kosovë dhe jashtë saj. Por, unë këtu do ta përshkruaj vetëm një ditë të zakonshme në gërmim.

Gjatë një dite të caktuar, në një lokalitet arkeologjik, mund të marrin pjesë në gërmime disa arkeologë, studentë dhe punëtorë. Pasi të bëhet ndarja e punëve dhe e përgjegjësisë, secili bënë punën e tij. Mjetet e punës kanë rëndësinë e tyre dhe secili student pajiset me to. Gërmimet zhvillohen në disa kuadrate në të njëjtën kohë. Brenda ditës në kuadrate ne mund të zbulojmë njësi stratigrafike të ndryshme si: shtresa humusi, kon-



Merita është studente në Hungari (MA në studime arkeologjike)

struksione arkitektonike (mure), dysHEME dhe shtresa me mbetje të lartë karbonike (djegie). Në këtë rast, të gjithë janë kurioz të dinë më shumë se pjesë e kujt ishte muri dhe çfarë funksioni kishte objekti. Në anën tjetër evidentimi i një dysHEMEJE të fut në mendime të tjera dhe përfundimisht një shtresë e djegies përmbyll një kapitull të jetës në këtë objekt ndoshta dhe në tërë vendbanimin. Pas evidentimit të njësive stratigrafike bëhet vendosja e numrave stratigrafik (US). Pastaj fillon procesi i dokumentimit dhe bëhet përshkrimi i shtresave dhe materialit arkeologjik në skeda përkatëse si dhe përgatitja e kuadratis për fotografim. Pas fotografimit bëhet vizatimi i planimetrive dhe profileve të kuadratis. ProceSIN e dokumentimit e konsiderojë si më të vështirën gjatë punës në teren. Ne, studentët, marrim pjesë në të gjitha

punët e lartpërmendura, duke u ndihmuar nga udhëheqësi i gërmimeve si dhe nga arkeologët e tjerë.

Gjatë një dite, pos materialit të palëvizshëm arkeologjik ne mund të gjejmë dhe material të lëvizshëm arkeologjik. Ai përfaqësohet kryesisht nga fragmentet e qeramikës dhe më pak nga fragmentet e qelqit, ato metalike dhe kocka kafshësh. Gërmimi është bërë me kujdes dhe të gjitha gjetjet e asaj dite janë vendosur në qese të veçanta mbi të cilat janë shkruar të dhënat për emrin e projektit, sektorin, kuadratin, shtresën dhe datën e gjetjes. Më pas këto gjetje iu nënshtrohen një procesi tjetër që quhet postgërmim e që nuk mund të kryhet brenda një dite të vetme.

Përpos aspektit profesional ne përjetojmë edhe emocione të ndryshme dhe përballemi, ndoshta për herë të parë,

me një jetë të ndryshme nga normalja, më tepër asketike. Ky stil jetese është edhe testi ynë i parë i pjekurisë jetësore dhe profesionale.

Të ndarë nga familja, duke jetuar brenda një shtëpie me studentë të tjerë, ne përballemi me kufijtë e durimit, organizmin e jetës dhe vështirësitë e kuptimit të punës profesionale. Zgjedhja e hershme dhe i përpiktë është sfida e parë që ne si studentë e përjetojmë larg kujdesit prindëror. Disiplina në punë dhe organizimi i jetës gjatë një vere të tërë është sfidë serioze.

Shënim:

[Kush do të gatuaj sonte? Do të hamë ushqim të përpunuar të dyqaneve (sallam, pashtetë, konservë...) apo do të ziejmë diçka për darkë? Sonte më mirë po hamë diçka të lëngshme, një supë do të

dëshiroja! Kush do i pastroj enët, kush do "i pastroj dhomat e banjat? Të gjithë studentët jemi në moshë të re dhe nuk kemi as përvoja gatimi e as organizimi shtëpiak. Epo, këto i ka gërmimi!

...Është momenti kur ora po afron 16:00 dhe udhëheqësi i gërmimeve signalizon përfundimin e punës për sot, pason një fishkëllimë e fuqishme që ta dëgjojnë të gjitha kuadratat, dhe një frymëmarrje e thellë lehtësimi nga të gjithë. Edhe sot mbaroi, si do të jetë e nesërmeja? Kush e di vallë!]



Gjatë studimeve BA, Merita ka marrë pjesë në gërmimet arkeologjike në Koman, Shqipëri

Rrëfimi i Elzës për arkeologjinë

(nga Elza Shipoli, studente e arkeologjisë, tani duke studiuar për MA në arkeologji në Hungari)

Si një vajzë mjaft kurioze për çdo gjë, qysh në shkollën fillore jam njoftuar me arkeologjinë si shkencë. Gjithçka filloi si një rastësi duke i ndërruar kanalet televizive kur hasa në një dokumentar arkeologjik, e që tani më është shndërruar në pjesë të jetës time. Mënyra se si arkeologët i trajtonin gjetjet dhe si vinin në konkludim ishte diçka fascinuese për mua. Kisha shumë pyetje në mendjen time sa që doja të isha edhe unë pjesë e saj.

Në vitin 2014 fillova studimet e mia në degën e arkeologjisë në Departamentin e Antropologjisë në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Secila informatë që merrja gjatë ligjëratave ishte një dëshirë më shumë për të vazhduar më tutje.

Gjatë studimeve fillova edhe gërmimet e mia të para. Ishte diçka krejtësisht e re për mua. Gjërat që në dokumentarin me të cilin u njoftova me arkeologjinë dukeshin të lehta, në realitet duhej shumë përkushtim dhe kujdes. Gjithçka duhej të trajtohej me shumë kujdes. Aq sa isha e entuziazmuar në të njëjtën kohë kisha edhe frikë se ndoshta po bëj ndonjë gabim diku, se ndoshta gjatë gërmimit po e shkatërroj ndonjë artefakt. Mirëpo, me ndihmën e drejtuesve të gërmimeve që njëkohësisht ishin edhe profesorët tanë, mësova shumë gjëra rreth arkeologjisë dhe gërmimeve dhe ndoshta kjo është atraktiviteti më i madh që unë e kam gjetë në arkeologji, sepse çdo ditë mësoj adicka te re dhe interesante si në ligjerata ashtu dhe në gërmime.

Vetë fakti që arkeologjia ndërlihet edhe me shumë disiplina të tjera nënkupton që asnjëherë nuk do të jetë diçka e mërzitur.

Sot jam studente e nivelit Master në Pázmány Péter Katolikus Egyetem në Hungari duke vijuar vitin e fundit në studime arkeologjike. Ky universitet ka bashkëpunime shumë të ngushta edhe me vendet e Lindjes së Mesme si Siria, Libani, Jordania, Egjipti, Iraku dhe Izraeli. Gjithsesi studimet e mia jashtë vendit nuk do të mund të realizoheshin pa përkrahjen e shtetit hungarez dhe Ambasadës Hungareze në Prishtinë, për të cilën do të jem mirënjohëse gjatë gjithë rrugëtimit tim profesional.

Për mua arkeologjia është një enigmë e tipit *puzzle* që kërkon t'i ketë të gjitha pjesët përbërëse të saj për t'i bashkuar, për të gjetur përgjigjen që ne e kërkojmë gjatë gërmimeve.



Hungaria jep mbi 50 bursa çdo vit për studentët e Kosovës në nivelin MA

IN MEMORIA


(Fatmir Peja 1948-2017)

Arkeologu Fatmir Peja, një ndër emrat më të shquar të arkeologjisë, epigrafisë dhe numizmatikës kosovare, u lind në Mitrovicë në vitin 1948. Shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në vendlindje, ndërsa studimet e larta për arkeologji i përfundoi pranë Universitetit të Zarës të Kroacisë, në vitin 1978.

Për një kohë punoi si mësimdhënës në “Gjimnazin e Gjakovës” (1976) si dhe në shkollën fillore “Lidhja e Prizrenit” në Pejë (1977-1979). Nga viti 1979 u punësua në Muzeun e Kosovës, institucion në të cilin punoi me përkushtim deri në vitin 2013 kur edhe arriti moshën e pensionit, dhe njihet si bartës i sukseseve të arritura nga Muzeu i Kosovës në sferën e hulumtimeve dhe studimeve në fushën e dijes arkeologjike.

Veprimtaria shkencore e Fatmir Pejës u zhvillua në disa drejtimi: në fushën e arkeologjisë, numizmatikës dhe atë të epigrafisë. Karrierën profesionale në fushën e arkeologjisë Fatmir Peja e filloi në lokalitetin e Ulpianës për të vazhduar me atë të Vendenisit. Hulumtimet në Vendenis vunë edhe bazat e njohurive shkencore lidhur me rëndësinë që kishte ky vendbanim, i cili deri në atë kohë njihej fare pak. Ai vijoi punën e tij me përkushtim në një sërë lokalitetesh, në gjithë territorin e Kosovës, kryesisht të periudhës së antikitetit dhe mesjetës së hershme, për t’a përmbyllur me zbulimin unik, jo vetëm në Ballkan, por edhe me gjerë, të kompleksit sakral të antikitetit të vonë në kështjellën e Harilaqit.

Si numizmat dhe epigrafist, Fatmir Peja ka dhënë një kontribut të çmuar në këto dy fusha. Duke qenë i ndërgjegjshëm për thesarin e pasur numizmatik të Kosovës, nga njëra anë, si dhe për mungesën e kuadrove shken-



Fatmir Peja, numizmat e epigrafist

core të kësaj disipline, studiuesi Fatmir Peja iu përkushtua kësaj fushe të cilës i dedikoi një pjesë të madhe të karrierës së tij profesionale. Falë kontributit të tij shkencor dhe profesional, Muzeu i Kosovës sot ka në fondet e tij një thesar të pasur numizmatik, i cili është mbledhur, studiuar dhe inventarizuar ndër vite. Krahas botimit të një pjese të këtij thesari, nga Fatmir Peja në organet dhe revistat shkencore vendore dhe ndërkombëtare, ai është autor i një studimi të veçantë monografik në këtë disiplinë. Si epigrafist Fatmir Peja ka bërë mbledhjen dhe inventarizimin e gjithë materialit epigrafik të zbuluar në Kosovë. Nga ana tjetër studimet e tij në fushën e epigrafisë, të referuara dhe publikuara në revista brenda dhe jashtë vendit, janë referenca domethënëse për secilin studiues të kësaj fushe. Veprimtaria e tij shkencore-hulumtuese, edhe pse jo shumë e gjerë për nga vëllimi, është shumë e pasur për nga vlerat. Studiuesi Fatmir Peja ka botuar një numër domethënës punimesh shkencore në gjuhët angleze, frënge, serbo-kroate dhe shqipe. Ai ka botuar si autor i vetëm përmbledhjen studimore “Monedhat Antike në

Kosovë” (2008), kurse në bashkautorësi ka botuar studimet monografike “Trashëgimia etnokulturore dhe historike e Llapit” (1995) dhe “Kalaja e Harilaqit” (2012). Fatmir Peja është gjithashtu bashkëautor i veprave “Harta Arkeologjike e Kosovës” vol. I (2006) dhe “Harta Arkeologjike e Kosovës” vol. II (2012) si dhe “Katalogu Arkeologjik i Muzeut të Kosovës” (2013). Rezultatet e punës së tij janë bërë publike gjithashtu në një sërë simpoziumesh dhe kongresesh shkencore brenda dhe jashtë vendit.

Arkeologu Fatmir Peja, pos që ishte një studiues i zellshëm, me nivel të larmueshëm akademik dhe profesional, ai ishte i dashur në mesin e kolegëve, dhe njëherit ishte edhe si far orientues për gjeneratat e ardhshme të arkeologjisë kosovare.

Në nderim të punës dhe veprimtarisë shkencore dhe profesionale në fushën e trashëgimisë arkeologjike, studiuesi Fatmir Peja u vlerësua post mortem, nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Kosovës, me çmimin për merita të veçanta “Shtjefën Gjeqovi”.

Gjueti antropologjike me aparat: imazhe nga një shtet i harruar i Evropës

Durim Abdullahu

(Kjo ese është shkruar nga Ass. MA Durim Abdullahu bashkë me studentët e vitit të parë të gjeneratës 2018/2019, gjatë ushtrimeve të lëndës *Shkrim akademik*. Të tilla ese, janë shkruar nga secili student, për librin e antropologut gjerman Hugo Adolf Bernatzik: “*Shqipëria: vendi i shqiptarëve*”.)

Me krahun e majtë e mbanë të shtërn-guar nën sjetull një fuçë druri me lesh deleje, kurse me dorën e djathtë tjerre leshin në fijen që rri varur në një shtizë druri, teksa me njërën këmbë tund djepin për ta futur fëmiun në gjumë. Ajo është një grua nga Peja, refugjate në Mbretërinë Shqiptare, e përndjekur nga Mbretëria e Jugosllavisë, prej vendit të saj, Kosovës. Këtu, ajo është fiksuar në një fotografi aparati në pranverën e vitit 1929, nga Hugo Adolf Bernatzik, një shkencëtar austriak i interesuar për etnologjinë aplikative.

“Gjuetia me aparat fotografik është shumë më e vështirë se sa gjuetia me pushkë”

Ai ishte njohur me botën shqiptare gjatë mbretërimit gjashtëmujor të Princ Vidit më 1914, kur vizitoi për të parën herë Shqipërinë. Lufta e Parë Botërore e ktheu sërish atje, ku shërbeu si vullnetar në ushtrinë austrohungareze që e kishte pushtuar gjysmën e territorit shqiptar. Kurreshtar për natyrën, Bernatzik u tërhoq shumë nga kënetat e bregdetit dhe zogjtë e tyre. I vetëdijshëm se ato ishin habitate të rralla zogjsh në Evropë, më shumë se dhjetë vjet pasi i kishte shkelur si ushtarak tokat shqiptare, Hugo Adolf Bernatzik u kthye në ato toka si gjuetar, për të gjuajtur me aparat fotografik. Në udhëpërshkrimin e tij të kësaj ekspedite, Bernatzik ka shkruar se “gjuetia me aparat fotografik është shumë më e vështirë se sa gjuetia me pushkë”. Në njërën prej rreth dyqind



Grua shqiptare duke tjerur

fotografive të koleksionit të tij nga udhëtimet nëpër Shqipëri, vetë Bernatzik shihet i ulur nën pemët e një fushe, veshur me këmbë, pantolona të shkurtër dhe me sandale.

Ai rri para tendës së tij të fushimit dhe kaikes me të cilën lundroi në kënetat si ajo e Maliqit, Tërbufit apo Karavastasë, për të fotografuar pelikanët dhe zogjtë e tjerë që atë kohë ende gjallnonin në to. Libri që ai e botoi pak kohë pas kthimit në Vjenë, “*Reisenpelikane und ihre Kinder*” (“*Pelikanët e mëdhenj dhe fëmijët e tyre*”) përveç të dhëna dhe përshkrime nga vëzhgimet e autorit të tij, përmban edhe një album të vogël fotografish me disa prej kolonive të fundit të pelikanëve në Shqipëri.

Por pelikanët nuk qenë i vetmi gjah në Shqipëri që ndoqi Bernatziku, ky gjuetar që në vend të çiftes gjuajti me aparat fotografik. Gjatë udhëtimeve të tij nëpër Shqipëri, mes 24 prillit dhe 6 korrikut të vitit 1929, Hugo Adolf Bernatzik, që një

vit më pas filloi të studionte etnologjinë, psikologjinë dhe gjeografinë në Universitetin e Vjenës, fotografoi dhe shumë ambiente nga përditshmëria e Shqipërisë së asaj kohe. Babë e bir që punojnë qeleshe, një nuse malësore, djem të rinj që pijnë kafe turke e argëtohen në Gjorm, shtëpitë e Krujës, një çift duke biseduar në tregun e Tiranës, dy burra teksa udhëtojnë me kalë, gra kosovare që tjerin lesh dhe endin qendisma në vegjë, një poçeri në Lushnjë, valltare cigane, arumunë nomadë me kasollet dhe çadrat e tyre dhe bullgarë në trevat lindore shqiptare, janë vetëm disa nga pamjet që ka kapur me aparatën e tij fotografik, Bernatzik.

Ky koleksion fotografish me një album të veçantë zogjsh brenda tij, janë shpjeguar në kontekstin dhe historinë që kanë mbrapa nga vetë Bernatzik, në librin “*Europa vergessenes Land*” (“*Shteti i harruar i Evropës*”) që ai e botoi po më 1930 në Vjenë. Titulli, tregon pozitën e Shqipërisë në publi-

kun europian, një “shtet i harruar i Evropës” apo një “shtet jetim i Evropës” siç e kishte quajtur në titull të një vepreje të vitit 1914, autori i saj, anglezi Wadham Peacock: “*Albania: The Foundling State of Europe*” (“*Shqipëria: shteti jetim i Evropës*”). Megjithëse luftërat ballkanike të viteve 1912 – 1914 e kishin dëbuar Perandorinë Osmane nga Europa, Shqipëria i takonte një zone europiane që edhe pas Luftës së Parë Botërore, gazetatat qëllonte që i referoheshin si “Orienti i Evropës”. E prapambetur si të ishte ende në mesjetë, e pafutur në modernitetet, e pazhvilluar, e paindustrializuar, pa rrugë të shtruara, pa ura, pa hekurudha, e paelektrifikuar dhe me një popullsi analfabete deri mbi 80 për qind që si qytetarë të një mbretërie të sapoformuar dhe jo të fortë, akoma jetonte në masë të madhe sipas zakonesh të vjetra e traditash juridike, Shqipëria e vitit 1929, ishte një parajsë për vrojtime etnografike dhe studime etnologjike për autorin e kësaj vepre. I njohur me idetë antropologjike të botës austro-gjermane, me “rrathët kulturore” dhe me veprat e Franz Boas, Fritz Graebner, Wilhelm Schmidt apo Leo Frobenius, Hugo Adolf Bernatzik ka shkruar një nga veprat më origjinale për botën shqiptare të ndërmjet dy luftërave botërore. E përshkruar nga kjo frymë teorike, me përmbajtjen e saj tekstuale e vizuale dhe me metodën që e prodhoi atë si një vëzhgim i dokumentuar me fotografi, kjo vepër është rezultat i një gjuetie antropologjike me aparat. Në vitin 1939, kur ajo u ribotua për të katërtën herë, Bernatzik e zgjeroi atë dhe ia ndryshoi titullin, duke e quajtur “*Albanien: das Land des Schkipetaren*” pra “*Shqipëria: vendi i shqiptarëve*”. Në po këtë vit, Europa u përfshi nga lufta më shkatërrimtare dhe më e përbotshme që ka njohur njerëzimi. Një vit më parë, më 12 mars 1938, Austria, vendi i Bernatzikut, ishte aneksuar nga Gjermania naziste, sipas një formule bashkimi politik të quajtur “Anschluss”. Kështu, “*Shqipëria: vendi i shqiptarëve*” po botohej



Bernatzik në tendë

në Rajhun e Tretë, ushtarët e të cilit do ta pushtonin vendin e shqiptarëve, po sipas një formule të zbutur duke “zëvendësuar” italianët pas kapitullimit të tyre më 1943 dhe duke krijuar një qeveri kolaboratore shqiptare të asaj që gjermanët e quanin Königreich Albanien, pra Mbretëria Shqiptare. Gjatë gjithë viteve të mëpastajme të shekullit të njëzet kjo vepër për Shqipërinë, do të mbetej gati krejt e panjohur në vendin e shqiptarëve. Vetëm në vitin 2003, ajo u botua në Tiranë nga Shtëpia Botuese Uegen, në një edicion që ruan titullin përfundimtar të origjinalit: “*Shqipëria: vendi i shqiptarëve*”. E përkthyer në shqip nga Taulant Hatia, nga 188 faqet e saj, vetëm 98 prej tyre përmbajnë tekst. Faqet e tjera kanë 93 fotografi nga ato që Bernatzik i bëri në Shqipëri më 1929, kur mbledhi materialin për këtë libër.

Kritika ndaj paragjytimeve për shqiptarët

Për Hugo Adolf Bernatzik Mbretëria Shqiptare e sapoformuar ishte një koloni e Italisë por që mund të shndërrohej në Kaliforni të Evropës. Me ndjesinë e antropologut ai vëren që “...rënia e kulturës popullore, e nisur nga Zogu, nuk po ndalet. Sot, një pjesë e madhe kostumeve kombëtare dhe e shtëpive muzeale të cilat gjenden në librin tim, janë zhdukur.” I papajtuar me imazhin e Shqipërisë në Evropë, si “...një vend plot hajdutë dhe rrezik, që udhëhiqet nga një mbret operetash, i cili i ngjan pak a shumë atyre vendeve kaukaziane...”, Bernatzik këmbëngul që në fillim të librit të tij që “nuk është e vërtetë që populli sh-

qiptar është i ndarë në dy klasa, në proletariatin e qytetit dhe në gjithë pjesën që mbetet... Gjithashtu nuk është e vërtetë që pyjet dhe kënetat janë të mbushura me njerëz të egër... Nuk është e vërtetë ajo që thuhet për këtë vend të çuditshëm dhe që është përshtatur nga konceptet perëndimore.” Duke kritikuar “mendjemadhësinë e modernitetit tonë që e ka tretur konceptin e kulturës” dhe duke u thirrur në një lloj objektiviteti shkencor, Bernatzik shkruan “se çfarë është ‘e vërtetë’ për Shqipërinë, lexuesi mund ta gjejë në rreshtat dhe pamjet e mëposhtme. Unë e përshkova këtë tokë së bashku me aparatin tim, hasa aty vendet he njerëz ashtu siç më dolën përpara. Qëllimi nuk ishte as gjurmimi sistematik, as ndarja klasore dhe raca. Nuk doja të ndreqja me këtë pohimet e paraqitura, por të ndreqja në mënyrë të përgjithshme opinionet e përhapura gjerësisht... Dhe për më tepër, ky libër nuk duhet të jetë shpëtimi i nderit, ashtu siç kam thënë tashmë, por duhet të bëhet një shpëtim i të vërtetës dhe i opinionit.”

Pas përshkrimeve shumë të gjalla dhe të ilustruara për malet, pyjet dhe kënetat, për pelikanët dhe faunën, qytetet e fshatrat shqiptare, mikrpitjen, kostumet, konceptin e kohës, traditat, zakonet dhe etnopsikologjinë e shqiptarëve, rrëfimi i Bernatzikut përmbillet me katërmbëdhjetë histori nga përditshmëria shqiptare, disa të dëgjua e disa të përjetuara nga vetë autori, mes të cilave edhe ngujimi i tij për nëntëmbëdhjetë orë në “Shpellën e djallit” pranë Sovjanit. Më 1953, themeluesi i konceptit të “antropologjisë alternative”, Hugo Adolf Bernatzik vdes pak ditë para se të arrinte moshën 56-vjeçare. Por 90 vjet pas udhëtimit të tij në Shqipëri dhe 80 pasi libri i tij mori formën përfundimtare, “*Shqipëria: vendi i shqiptarëve*” ka arritur atë që vetë Hugo Adolf Bernatzik vështirë se mund ta ketë përfytyruar ndonjëherë: në vendin e shqiptarëve, ky libër, tani diskutohet dhe studiohet nga studentët në Departamentin e Antropologjisë Kulturore në Universitetin e Prishtinës dhe nga Instituti i Antropologjisë Kulturore në Tiranë.

Tryezë



Departamenti i Antropologjisë
organizon tryezë të hapur brenda departamentit me temën

“Antropologjia dhe terminologjia”

E premte, 13 dhjetor 2019
Salla 127, Kati 1, Fakulteti Filozofik

Tryeza organizohet në dy sesione:

- a) arkeologji
- b) antropologji kulturore

9.00 – 9.30
(Kafe e mëngjesit)

9.30 – 11.30
“Termet dhe konceptet në diskursin arkeologjik shqiptar”
Moderon: Prof. Ass. Dr. Arben Hajdari

11.30 - 13.00
(Dreka)

13.00 – 15.00
“Termet dhe konceptet në diskursin antropologjik shqiptar”
Moderon: Prof. Ass. Dr. Arsim Canolli

15.00 -15.30
(Përmbyllja dhe kafa e pasdrekës)

Në tryezë do të paraqesin kumtesat e tyre ligjëruesit e Departamentit të Antropologjisë. Së shpejti do t’ju njoftojmë edhe me temat e tyre në kuadër të sesioneve. Për më shumë informacion, na shkruani te antropologjia@uni-pr.edu dhe do t’ju përgjigjemi.

Ligjëratë nderi

Prof. Dr. Ukë Xhemaj

Departamenti i Antropologjisë
organizon ligjëratë nderi dhe konverzacion me

Prof. Dr. Ukë Xhemaj
24 tetor 2019
ora: 16.30 - 18.00
Salla 03, Kati përdhësë, Fakulteti Filozofik



Profesor Ukë Xhemaj ka ligjëruar në Departamentin e Antropologjisë prej kur është themeluar më 2002 deri në qershor të vitit 2019. Ai i përket etnologëve të brezit të parë të Kosovës, me përvojë prej pesë dekadash. Puna e tij është themeltare për zhvillimin e Departamentit të Antropologjisë, si profesor e si udhëheqës. Në këtë takim nderi me kolegë e studentë, profesor Xhemaj do të na nderojë me rrëfime për përvojën e tij si etnolog, punën në terren, mësimdhënien dhe perspektivën e antropologjisë kulturore në Kosovë.

Moderator: Arsim Canolli

Pas ligjëratës do të ketë një koktej rasti në sallën 127.

Mirë se vini!



1. "Archaeology in Albania and Kosova: a view on the past and the present"

Prof. Dr. Jean-Luc Lamboley, Université de Lyon, France

31 tetor 2019, ora: 16.00 - 17.30

Salla 03, Kati përdhesë, F. Filozofik

2. "Trashëgimia atocitare: një qasje e re mbi studimin e të pagjeturve në Kosovë gjatë luftës 1998-1999"

Nora Weller, (PHD Researcher), University of Cambridge, Department of Archaeology and Anthropology, United Kingdom

21 nëntor 2019, ora: 16.00 - 17.30

Salla 03, Kati përdhesë, F. Filozofik

3. "Applied geophysical methods in archaeological prospecting"

Dr. Michel Dabas, National Centre for Scientific Research/CNRS/ENS, Archéologie et Philologie d'Orient et d'Occident, France

19 dhjetor 2019, ora: 16.00 - 17.30

Salla 03, Kati përdhesë, F. Filozofik

4. "New explorations in archaeology: a discussion of initial results of field survey in Peja and Istog, Kosova"

Prof. Dr. Michael Galaty, University of Michigan/Michigan Museum of Anthropological Archaeology (director), USA

16 janar 2020, ora: 16.00 - 17.30

Salla 03, Kati përdhesë, F. Filozofik

5. "The importance of archaeobotany in the archaeological interpretation"

Dr. Florian Jedrusiak, researcher in carpology and archaeobotany, Université Paris Ouest Nanterre La Défense, France

27 shkurt 2020, ora: 16.00 - 17.30

Salla 03, Kati përdhesë, F. Filozofik

6. "Reanimating Contested Spaces (ReSpace): Designing Participatory Civic Education for and with Young People in Kosovo and Rwanda"

Dr. Paula Callus, Head of Research, NCCA (National Center for Computer Animation)

Faculty of Media and Communication, Bournemouth University, United Kingdom

26 mars 2020, ora: 16.00 - 17.30

Salla 03, Kati përdhesë, F. Filozofik

7. "Tinguj dhe zëra qytetës: Elbasani në regjistrimet zanore të arkivit audivizual të IAKSA-s"

Dr. Mikaela Minga, hulumtuese shkencore dhe udhëheqëse e Departamentit të Folklorit/Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit/ASA, Tiranë

30 prill 2020, ora: 16.00-17.30

Salla 03, Kati përdhesë, F. Filozofik

8. "The intersection between ethnobotany and food anthropology: the case of Albania and Kosovo"

Dr. Andrea Pieroni, professor of ethnobotany and ethnobiology/rector of Università di Scienze Gastronomiche di Pollenzo, Italy

28 maj 2020, ora: 16.00 - 17.30

Salla 03, Kati përdhesë, F. Filozofik

Për më shumë informata kontaktoni: arsim.canolli@uni-pr.edu ose/dhe arben.hajdari@uni-pr.edu

Pas ligjëratës do të ketë koktej të lehtë. Mirë se vini!